



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-053
Prishtinë, më 19 shkurt 2016, ora 10:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 DHE 24 SHKURT 2016**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Sabri HAMITI, nënkryetar i Kuvendit.

Para se t'i hapë punimet e seancës së sotme plenare, me miratim të kryetarit të Kuvendit, z. Kadri Veseli, Kuvendit iu drejtua deputeti Visar Ymeri.

Visar Ymeri tha se, siç e keni parë të gjithë, ka një lëvizje shoqërore tashmë jashtë, që insiston në largimin e këtij regjimi. Një lëvizje e qytetarëve sovranë, të cilët janë pa bishta. Ata brohorasin në mbrojtje të Republikës, e nuk ulërijnë.

205 mijë qytetarë të peticionit, qindra mijëra qytetarë të protestave, shoqëria civile, intelektualët, i kanë shpallur “Zajednicën” dhe Demarkacionin të vdekura.

Gjykata Kushtetuese e ka shpallur këtë regjim antikushtetutes.

Ju qytetarë të Republikës së Kosovës ia keni hequr maskën këtij regjimi mashtruesish, e keni shpallur atë jolegjitim, antidemokratik, antirepublikë.

Prandaj, regjimin Mustafa-Thaçi nuk do ta lejojmë të sillet si Qeveri e Republikës së Kosovës.

Ky regjim sundimtarësh po mundohet ta mbajë veten dhunshëm në këto karrige.

Po mundohet dhunshëm ta mbajë shtetin të kapur.

Po mundohet dhunshëm të mbajë seanca për ta thelluar kapjen e shtetit, për ta zgjeruar atë deri në majën e tij. Pra, deri në Presidencë.

Deputetët po i kidnapojnë, po i arrestojnë e mbajnë burgjeve. Aktivistët po i përndjekin e mbajnë burgjeve, po i rrahin nëpër maune e stacione policore.

I fusin armët e zjarrit e njësitë elite të Policisë në zyrat e opozitës. E keqpërdorin atë duke e ndërsyer kundër popullit. Fshihen prapa Policisë. E gjuajnë gurin dhe nuk kanë guxim ta tregojnë dorën.

Kjo Qeveri nuk ka qenë kurrë. Ka filluar si regjim dhe po përfundon si regjim. Por, ama ky është fundi i saj.

Këtë duhet ta kuptojnë Isa dhe Hashimi. Këtë duhet ta kuptoni të gjithë ju këtu në sallë. Sepse, populli e ka kuptuar këtë shumë më herët se ju.

Populli tashmë ka vendosur - regjimi Mustafa-Thaçi nuk është më.

Pas kësaj, kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës përgatitur nga Kryesia e Kuvendit.

Kryetari Kadri Veseli, para se të fillojë me rendin e ditës, tha se për shkak se në ndërkohë dy nga deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, pa të drejtë janë dënuar nga një gjykatë në Serbi, do të paraqes para Kuvendit një propozim-Deklaratë dhe i ftoi deputetët që t'a miratojnë atë.

Pas hedhjes në procedurën e votimit, kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi këtë:

D E K L A R A T Ë

- Kuvendi i Republikës së Kosovës shpreh shqetësim për farsën e Gjykatave të Serbisë në dënimin e ish-Ushtarëve të UCK-së,
- Për Kuvendin e Republikës së Kosovës, dënimet tilla janë politike dhe ndikojnë direkt edhe në raportet Kosovë - Serbi,
- Kuvendi i Republikës së Kosovës këto akte i konsideron pa vlerë juridike,
- Kuvendi i Republikës së Kosovës fton autoritetet ndërkombëtare të ndikojnë në institucionet ndërkombëtare, si Interpol, Europol, etj. që të refuzojnë çdo kërkesë të autoriteteve të Serbisë dhe t'i kuptojnë këto akte politike si pa efekte juridike,
- Kuvendi i Republikës së Kosovës do të angazhohet direkt dhe kërkon nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare që të ndërmarrin veprime për anulimin e këtyre akteve dhe akteve tjera akuzuese fiktive dhe politike.

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Më tutje, kryetari tentoi t'i vazhdojë punimet e seancës plenare, duke i ftuar deputetët që të qëndrojnë në sallë, me përjashtim të atyre që mund të kenë probleme shëndetësore.

Më pas, kryetari e ndërpreu seancën dhe e caktoi një pauzë prej 5 minutave.

Pas pauzës, kryetari i njoftoi deputetët se me kërkesë të kryetarit të Kuvendit e me vendim të Presidentes së Republikës së Kosovës, është bërë zëvendësimi i deputetëve, si në vijim:

1. Z. Avdyl Imeri, në vend të ish-deputetit Latif Gashi dhe
2. Z. Bislim Zogaj, në vend të ish-deputetit Rustem Mustafa.

Këto zëvendësime janë nga Koalicioni PDK-PD-LB-PSHDK DHE PKK.

Deputetëve të rinj kryetari u dëshiroi mirëseardhje dhe i ftoi ata që ta nënshkruajnë tekstin e betimit.

Deputeti Avdyl Imeri dhe deputeti Bislim Zogaj e nënshkruan tekstin e betimit.

Deputetët nga radhët e grupeve parlamentare opozitare përsëri hodhën gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Edhe pas kësaj, kryetari i vazhdoi punimet e seancës plenare, duke i ftuar deputetët që të qëndrojnë në sallë, me përjashtim të atyre që mund të kenë probleme shëndetësore.

Kryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati asnjë deputet të paraqitur për fjalë.

2. Koha për pyetje parlamentare

Kryetari konstatoi se për këtë seancë nuk është parashtruar asnjë pyetje parlamentare.

Sa u takon pyetjeve me shkrim, ministri për Komunitete dhe kthim, Dalibor Jevtiq, është përgjigjur në pyetjen e deputetit Ismajl Kurteshi, shifra DO-854, e parashtruar më 14 janar 2016.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Për shkak të hedhjes së gazit lotsjellës në ato momente dhe daljes së deputetëve nga salla, kjo pikë nuk u procedua me votim.

Gjithashtu, edhe në vazhdimet tjera të kësaj seance pas pauzave që bëheshin, nuk u procedua me votim kjo pikë e rendit të ditës.

* * *

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën përsëri gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Pas hedhjes për herë të dytë të gazit lotsjellës, kryetari e ndërpreu përsëri seancën plenare dhe e caktoi një pauzë prej 5 minutave.

* * *

Pas pauzës, kryetari Kadri Veseli tha se do ta vazhdojmë seancën plenare për hir të interesit qytetar. Ka pika të parapara për shqyrtim për këtë seancë plenare, që kanë të bëjnë me liberalizimin e vizave, pastaj një projektligj i cili pritet të miratohet sot edhe me 60 milionë e 800 mijë euro në të mirë të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Kryetari u bëri thirrje deputetëve të opozitës të kenë më shumë mirëkuptim për të gjithë ne. I kisha lutur edhe një herë për arsye se vërtet janë duke na dëmtuar si imazh i shtetit. Tek e fundit, edhe veten, theksoi ai.

Më pas, kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka propozuar Kuvendit që shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068 të bëhet me procedurë të përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Kryetari në vazhdim e ftoi deputetin Naser Osmani për paraqitjen dhe arsyetimin e propozimit të lartpërmendur.

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se komisioni që ai udhëheq i propozon Kuvendit që shqyrtimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068, të bëhet në bazë të procedurës së përshpejtuar - shmangie nga Rregullorja e Kuvendit, dhe atë që shqyrtimi i parë i këtij projektligji të bëhet në këtë seancë, ndërsa shqyrtimi i dytë i i tij të bëhet në seancë plenare të veçantë.

Fjala e deputetit Naser Osmani është dhënë e plotë në transkript.

Më pas, kryetari e hodhi në votim miratimin e propozimit të lartpërmendur nga Naser Osmani për shmangie nga Rregullorja lidhur me shqyrtimin e projektligjit të lartpërmendur.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,

Kundër ----- 1,

Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. Për shmangie nga afatet procedurale të parapara më nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët 3, 8 dhe 9, të Rregullores së Kuvendit për shqyrtimin dhe miratimin Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068, si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe me Ligjin nr.05/L-068 bëhet në seancën plenare më 19 shkurt 2016.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068 të bëhet në seancë plenare të radhës, e cila do të mbahet me datë 19 shkurt 2016, në orën 19:00.

* * *

Deputetë nga radhët e grupeve parlamentare opozitare hodhën përsëri gaz lotsjellës në sallën e seancës plenare të Kuvendit.

Pas hedhjes për herë të tretë të gazit lotsjellës, kryetari e ndërpreu përsëri seancën plenare dhe caktoi pauzë.

* * *

Pas pauzës, kryetari i njoftoi deputetët se ekzistojnë disa ankesa nga zyrtarët policorë për sjellje joadekuate të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, që nuk janë vetëm nga opozita. Zyrtarët policorë kanë shprehur ankesa edhe zyrtare për arsye se disa nga deputetët e pozitës i kanë fyer policët.

Deputeti Armend Zemaj theksoi se do të ishte mirë që para Kuvendit të dihet kush nga deputetët konsiderohet se ka shkaktuar fyerje ndaj zyrtarëve policorë.

Kryetari Kadri Veseli, në lidhje me këtë çështje, tha se këtë do ta bëjë publike, pasi në Kuvend të ketë arritur raporti nga Policia e Kosovës.

Fjala e kryetarit Kadri Veseli dhe deputetit Armend Zemaj është dhënë e plotë në transkript.

Më tutje, në lidhje me rrethanat politike të krijuara në Kuvend, për fjalë u paraqitën deputetët: Ilir Dedaj, Ismet Beqiri, në emër të GP të LDK-së; Enver Hoxhaj, në emër të GP të PDK-së; Alma Lama dhe Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

* * *

Në lidhje me rendin e ditës për fjalë u paraqitën: ministri Arsim Bajrami dhe nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti.

Ministri Arsim Bajrami kërkoi që pika e propozuar - Shqyrtimi i parë i Projektligjit për arsimin e lartë në Republikën e Kosovës të shtyhet për një tjetër seancë plenare.

Nënkryetari Sabri Hamiti propozoi që pikat e propozuara, si në vijim:

- Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
- Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas,
- Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë-UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK,

- Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit,
- Votimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i ri-proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë dhe
- Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektionin Bujqësor, të shtyhen për vazhdimin e kësaj seance plenare, për shkak të mungesës së kuorumit, siç kërkohet për miratimin e shumicës së tyre.

Nënkryetari Sabri Hamiti, më pas foli edhe në lidhje me zhvillimet e fundit politike në vend. Fjala e ministrit Arsim Bajrami dhe nënkryetarit Sabri Hamiti është dhënë e plotë në transkript.

Kryetari kërkoi që lidhur me propozimin e ministrit Arsim Bajrami dhe nënkryetarit Sabri Hamiti të deklarohen përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Për këtë çështje u deklaruan deputetët: Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së dhe Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Kryetari i hodhi në votim propozimet e lartpërmendura të ministrit Arsim Bajrami dhe nënkryetarit Sabri Hamiti.

Kuvendi nëpërmjet një votimi formal i miratoi propozimet e lartpërmendura të ministrit Arsim Bajrami dhe nënkryetarit Sabri Hamiti.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë rend dite:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për kundërvajtje,
9. Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit,
10. Shqyrtimi i propozim-Rregullores për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij,
11. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016,
12. Zgjedhja e një (1) anëtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës,
13. Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068.

Ministri Abdullah Hoti tha se ky projektligj rregullon procedurat dhe kriteret e emërimit të anëtarëve të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), arsyet e shkarkimit të anëtarëve, si dhe organizimin e brendshëm të OSHP-së.

Projektligji përmban vetëm pesë nene.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Avdullah Hoti është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa; Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS; Fikrim Damka, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Teuta Sahatqija dhe Zenun Pajaziti, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068.

Në sallë ishin të pranishëm 74 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 70,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237 dhe me Ligjin nr. 05/L-068.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime për seancën plenare të radhës, e cila do të mbahet më 19 shkurt 2016, në orën 19:00.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve.

Ministri Arban Abrashi tha se ky projektligj rregullon procedurat e regjistrimit të të papunësuarve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve, ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësim nga Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës dhe detyrimet e tyre ndaj kësaj agjencie për të marrë këto shërbime që kanë synim rritjen e punësimit dhe parandalimin e papunësisë afatgjatë në Republikën e Kosovës.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Flora Brovina, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Hatim Baxhaku, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për regjistrimin dhe ofrimin e shërbimeve dhe masave për punësimin e të papunëve, punëkërkuessve dhe punëdhënësve.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Ministri Arban Abrashi tha se ky projektligj krijon mundësi më të mira për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuar, në harmoni me ofertën dhe kërkesën në tregun e punës.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe i ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Arban Abrashi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Flora Brovina, në emër të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Njomza Emini, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Salihe Mustafa dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-019 për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin FunkSIONAL për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

Ministrja Hykmete Bajrami tha se ky projektligj ka për qëllim nxitjen, tërheqjen dhe krijimin e kushteve më të mira për realizimin e investimeve strategjike në Republikën e Kosovës.

Projektligji i përcakton procedurat administrative dhe kriteret për vlerësimin, zgjedhjen, zbatimin dhe mbikëqyrjen e projekteve strategjike si dhe përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim të pronës së Republikës së Kosovës për realizimin e projekteve për investime strategjike.

Në vazhdim, ajo foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministres Hykmete Bajrami është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi Sabri Hamiti e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri; Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Slavko Simiq, në emër të Grupit Parlamentar LS dhe Danush

Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Agim Aliu dhe Ramiz Kelmendi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 60,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për investimet strategjike në Republikën e Kosovës.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kundërvajtje

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për kundërvajtje.

Ministri Hajredin Kuçi tha se ky projektligj ka për qëllim reformat e përgjithshme në sistemin gjyqësor dhe të së drejtës penale.

Nevoja për hartimin e projektligjit qëndron edhe në faktin tjetër se ligji në fuqi është ligj i vjetër nga ish-Jugosllavia, i cili ishte miratuar fillimisht në vitin 1979.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Hajredin Kuçi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Selvije Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit; Agim Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, dhe Danush Ademi, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për kundërvajtje.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për kundërvajtje.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin Funksional për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

9. Shqyrtimi i Parë i Projektligjit për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Ministri Kujtim Shala tha se ky projektligj rregullon përkrahjen dhe mbështetjen financiare dhe materiale të aktiviteteve kulturore, rinore dhe sportive përmes sponsorizimeve dhe donacioneve.

Në vazhdim, ai foli për strukturën dhe përmbajtjen e këtij projektligji dhe ftoi deputetët për miratimin në parim të këtij projektligji.

Fjala e ministrit Kujtim Shala është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin në parim të këtij projektligji.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan deputetët: Nait Hasani, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport; Bekim Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së; Salih Morina, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, si dhe Raif Qela dhe Shaip Muja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,

Kundër ----- 1,

Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Projektligjin për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin Funksional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, si dhe komisionet e përhershme për shqyrtimin e këtij projektligji dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit.

10. Shqyrtimi i propozim-Rregullore për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij

Kryesuesi e ftoi znj. Lirije Kajtazi, kryetare e Komisionit Funksional për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, në cilësinë e hartuesit të kësaj propozim-rregulloreje, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozim-Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.

Lirije Kajtazi tha se miratimi i kësaj propozim-Rregulloreje është në favor të rritjes së efektivitetit të normimit dhe në favor të lehtësimit të zbatimit të Ligjit për Avokatin e Popullit në praktikë.

Në vazhdim, ajo foli për strukturën dhe përmbajtjen e kësaj propozim-Rregulloreje dhe i ftoi deputetët për miratimin e saj.

Fjala e deputetes Lirije Kajtazi është dhënë e plotë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për shqyrtimin kësaj propozim-Rregulloreje.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputetja Salihe Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, diskutimi e së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Më tej, kryesuesi e hodhi në votim propozim-Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 61,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi Rregulloren për procedurat e zgjedhjes dhe shkarkimit të Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të tij.

11. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, paraqiti dhe arsyetoi para Kuvendit raportin me rekomandime të Komisionit FunkSIONAL, diskutimi e të cilit është dhënë i plotë në transkript.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e kësaj pike të rendit të ditës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputetja Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, diskutimi e së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Më pas, kryesuesi e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me kërkesën e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operacionale prej 0,082% dhe taksës investive prej 0,398% për vitin 2016.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 59,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për caktimin e taksës operacionale prej 0,082% dhe taksës investive prej 0,398%, për vitin 2016.

12. Zgjedhja e një (1) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Kryesuesi Sabri Hamiti, i propozoi Kuvendit që kjo pikë si dhe pika tjetër **nr. 13. - Zgjedhja e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës**, të votohen përnjëherë.

Kuvendi përmes një votimi formal, miratoi propozimin që votimi i fshehtë për dy pikat e lartpërmendura të bëhet përnjëherë.

Deputetja Selviqe Halimi, në emër të Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e paraqiti dhe arsyetoi raportin me rekomandime për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Ndërsa deputetja Xhevahire Izmaku, në emër të Komisionit ad-hoc, e paraqiti dhe arsyetoi raportin me rekomandime për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.

Më tej, kryesuesi sqaroi se për zbatimin e procedurës së votimit të fshehtë kërkohet krijimi i një komisioni votues nga përbërja e deputetëve, me mbështetje të zyrtarëve të Administratës, dhe ftoi përfaqësuesit e grupeve parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues.

Grupet parlamentare propozuan këta anëtarë:

1. GP PDK - Hajdar Beqa,
2. GP LDK - Salih Morina,
3. GP “Vetëvendosje” - _____,
4. GP AAK - _____,
5. GP LS - Jelena Bontiq,
6. GP “Nisma” - _____,
7. GP “6+” - Danush Ademi.

Kuvendi miratoi emërimin e anëtarëve në Komisionin votues.

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin për zgjedhjen e një (1) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës e paraqiti deputeti Salih Morina.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 74 deputetë, ndërsa i pavlefshëm është 1 fletëvotim.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Dragan Veljković ka fituar 57 vota, ndërsa Nenad Lazić ka fituar 16 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, procedura e votimit duhet të përsëritet.

Pas numërimit të fletëvotimeve për zgjedhjen e dy anëtarëve të Bordit të RTK-së, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Hajdar Beqa.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 74, ndërsa të pavlefshme janë 2 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Ismet Osdautaj ka fituar 24 vota, Fadil Miftari ka fituar 32 vota, Naim Gashi ka fituar 38 vota, dhe Naim Zeqiri ka fituar 32 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, anëtarë i Bordit të RTK-së u zgjodh, Naim Gashi. Ndërsa, në raundin e dytë të votimit hyjnë emrat e kandidatëve: Fadil Miftari dhe Naim Zeqiri.

Rundi i dytë

Në vazhdim, deputetët u ftuan një nga një për të votuar.

Pas numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, Raportin për zgjedhjen e një (1) anëtarit në Këshillin Gjyqësor të Kosovës, e paraqiti deputeti Salih Morina.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 75 deputetë, ndërsa të pavlefshme nuk është asnjë fletëvotim.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Dragan Veljković ka fituar 59 vota, ndërsa Nenad Laziq ka fituar 16 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, Dragan Veljković zgjidhet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Pas numërimit të fletëvotimeve për zgjedhjen e anëtarit të Bordit të RTK-së, në emër të Komisionit votues, raportin e paraqiti deputeti Salih Morina.

Ai konstatoi se në votim morën pjesë 75, ndërsa të pavlefshme janë 3 fletëvotime.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Fadil Miftari ka fituar 41 vota, ndërsa Naim Zeqiri ka fituar 31 vota.

Ai konstatoi se në bazë të rezultatit të votimit, anëtarë i Bordit të RTK-së u zgjodh Fadil Miftari.

Në përfundim të këtyre dy pikave të rendit të ditës kryetari konstatoi se Kuvendi mori vendimet si në vijim:

V E N D I M

për emërimin e anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Republikës Kosovës

1. Dragan Veljković emërohet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Republikës së Kosovës.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat pesë (5) vjet.

V E N D I M

për emërimin e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës

I. Anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës emërohen:

1. Naim Gashi dhe
2. Fadil Miftari.

II. Mandati i të emëruarve në pikën I. (një) të këtij vendimi zgjat tri (3) vjet.

Në fund, kryetari konstatoi se vazhdimi i kësaj seance do të bëhet më 24 shkurt 2016, në orën 14:00.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 19:15 minuta.

* * *

E mërkurë, 24 shkurt 2016

Vazhdimi i seancës, e filluar më 19 shkurt 2016

Seancën e drejtoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të seancës plenare, të filluar më 19 shkurt 2016.

Kryetari, para se të vazhdojë me pikat e parapara të rendit të ditës, e njoftoi Kuvendin me propozimin e Grupit Parlamentar “6+” për zëvendësimin e kryetarit në Komisionin Parlamentar.

Pas hedhjes në votim, kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Deputetja Duda Balje, emërohet kryetare e Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, në vend të deputetit Fikrim Damka.

2. Vendimi hyn në fuqi ditën e miratimit.

Më pas, ai procedoi me pikat si në vijim:

1. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10

Kryetari njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë dhe për dy pikat e radhës kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 14 dhjetor 2015, ndërsa në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2015 dhe në atë të datës 19 shkurt 2016 kishte mungesë të kuoromit, andaj procedimi me votim do të bëhet në seancën e sotme.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 85 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 83,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr. 05/L-072 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10.

2. Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës.

2. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 85,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Kuvendi e miratoi Projektligjin nr. 05/L-073 për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas.

2. Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës.

3. Votimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë-UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Më pas, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë-UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK.

Ai konstatoi se në sallë janë të pranishëm 86 deputetë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 76,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi projektligjin nr. 05/L-076 për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë-UniCredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të Kardiologjisë Invazive në QKUK.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Ministri Arsim Bajrami tha se ratifikimi i kësaj marrëveshje ka për qëllim forcimin e sistemeve të përzgjedhura që kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë, llogaridhënies dhe efikasitetit të arsimit në Republikën e Kosovës.

Ai theksoi se projekti për përmirësimin e sistemit të arsimit përbëhet prej tri pjesëve, si në vijim:

1. Përmirësimi i planifikimit strategjik, menaxhimit të financave, monitorimit dhe vendimmarrjes në sektorin e arsimit.
2. Forcimi i kapaciteteve menaxhuese dhe të llogaridhënies dhe
3. Mbështetje për zbatim të projektit dhe komunikim.

Në vazhdim, ministri Bajrami u fokusua në pasqyrimin e secilës prej këtyre pjesëve të marrëveshjes.

Në fund, ministri i ftoi deputetët për miratimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Pastaj, kryetari i hapi debatin për shqyrtimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Raportin me rekomandime në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, lidhur me shqyrtimin e këtij projektligji e paraqiti deputeti Naser Osmani, i cili theksoi se Komisioni që ai udhëheq i ka propozuar edhe dy amendamente.

Kryetari sqaroi se miratimi i këtij projektligji kërkon së paku 80 vota “për” dhe i nënshtrohet vetëm një shqyrtimi.

Kryetari më pas hodhi në votim një nga një dy propozim-amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i miratoi amendamentet nr. 1 dhe nr. 2.

Më pas, kryetari hodhi në votim në tërësi Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 82,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Ligji nr. 05/L-086 për ratifikimin e Marrëveshjes për financim ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për realizimin e Projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit.

2. Ligji i dërgohet për shpallje Presidentes së Republikës së Kosovës.

5. Votimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Kryetari tha se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 14 dhjetor 2015, ndërsa në seancën e mbajtur më 17 dhjetor 2015 dhe në atë të datës 19 shkurt 2016 kishte mungesë të kuorumit, andaj procedimi me votim do të bëhet në seancën e sotme.

Në vazhdim, kryetari i njoftoi deputetët se duke u bazuar në nenin 144, paragrafi 2 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, çdo ndryshim do të kërkojë miratimin e 2/3-ve të të gjithë deputetëve të Kuvendit, përfshirë dhe 2/3-at e të gjithë deputetëve të Kuvendit që mbajnë vendet e garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve, që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës, që do të thotë se nevojiten 80 vota, përfshirë këtu 14 vota të komuniteteve të tjera.

Të pranishëm në sallë ishin 83 deputetë.

Kryetari e hodhi në votim propozim-amendamentin 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 80,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se nëntëmbëdhjetë (19) deputetë nga radha e komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës kanë votuar “për” propozim-amendamentin 25.

Kryetari më tej konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet amendamenti nr. 25 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
2. Ndryshimet kushtetuese hyjnë në fuqi menjëherë pas miratimit të tyre në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin

Kryetari i njoftoi deputetët se ministrja Hykmete Bajrami nëpërmjet një shkrese ka kërkuar nga Kuvendi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës për seancën e radhës për shkak të udhëtimit zyrtar të saj jashtë vendit.

Kuvendi e miratoi kërkesën e lartpërmendur.

7. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë.

Deputeti Nuredin Ibishi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës, e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë.

Diskutimi i deputetit Nuredin Ibishi është dhënë i plotë ne transkript.

Kryetari r hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati të paraqitur asnjë deputet.

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Policinë.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 71,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë.

8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratit Bujqësor

Kryetari i njoftoi deputetët për raportin me rekomandimet të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratit Bujqësor.

Deputeti Adem Salihaj, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor e paraqiti dhe arsyetoi para deputetëve raportin me rekomandime lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratin Bujqësor.
Diskutimi i deputetit Adem Salihaj është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari hapi debatin për shqyrtimin e raportit të lartpërmendur.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutoi deputetja Emilija Rexhepi, në emër të GP të PDK-së, diskutimi i së cilës është dhënë i plotë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin me rekomandime të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratit Bujqësor.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 72,
Kundër ----- 1,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Bujqësi, Pylltari dhe Mjedis e Planifikim Hapësinor lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Inspektoratit Bujqësor.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 15:13 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

*Procesverbalin e hartoi: Selman Ymeri,
zyrtar i lartë ligjor*